Unë i nënshkruari _____, me cilësinë e _____ të personit juridik _____ deklaroj se:

Përbushim të gjitha specifikimet teknike, të përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe e vërtetojmë këtë me çertifikata e dokumenta (nëse kërkohen nga autoriteti kontraktor), të dorëzuar bashkë me këtë deklaratë.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 6

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

DEKLARATË **Mbi konfliktin e interesave**

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Konflikt i interesit është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejta ose të tërthorta që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësi të tij publike.

Në zbatim të nenit 21 pika 1 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve përcaktuar në Kreun III, Seksioni II, që iu ndalohej në mënyrë absolute të përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga lidhja e kontratave me një palë një institucion publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, zvkryeministri, ministrat, ose zvministrat, Deputetet, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët e Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë e në atë të Apelit, Avokati i Popullit, Anëtari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Anëtarët e Enteve Rregullatore, (Këshilli i Mbikqyrjes i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zv/Guvernatorin; të konkurrencës, telekomunikacionit; energjisë; furnizimit me ujë; të sigurimeve; letrave me vlerë; mediave), Sekretarët e Përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar tjetër, në çdo institucion publik, që është të paktën i barazvlefshëm për nga pozicioni me drejtorët e përgjithshëm, titullarët e institucioneve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për zyrtarët e nivelit të mesëm drejtues sipas nenit 31, dhe për zyrtarët e parashikuar në nenin 32 të kreut të III, seksioni 2 të këtij ligji, ndalimi sipas pikës 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave në fushën e territorit dhe të juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë është një institucion i varësisë.

Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit a të nënkryetarit të bashkisë, komunës ose të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave privatë të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie (neni 21 pika 2 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e përcaktuara në nenin 21 pika 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin që në kuptim të këtij ligji janë **bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi, fëmijë në moshë madhorë, prindërit e zyrtarit të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es.**

Unë i nënshkruari _____, me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në **Kreun III, Seksioni II** të Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv),
- c) nuk është dënua për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënua me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 4.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*

b. *Deklarate për paraqitje oferte të pavaruar, sipas Shtojcës 1/1;*

c. *Deklaratën mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 4/1;*

ç *Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;*

d. *Deklaratën mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 6;*

dh. *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

2. Për të provuar përmbushjen e kapaciteteve të mëposhtme, Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Për kapacitetin ligjor/profesional:

Ofertuesi duhet të paraqesë dokumentat e kërkuara në kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit(Shtojca 7).

- A. Operatori ekonomik duhet të disponojë Leje Mjedisore tipi A (me kod III.1.C), së bashku me Akt Miratimin përkatës, si dhe liçencë Profesionale Përkatëse të kategorisë III.2.B (*Për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore*), që të përfshijnë mbetjet me kod 18 01 02 dhe 18 01 09 ku procedura e asgjësimit të jetë me incenerim.
- B. Operatori Ekonomik duhet të disponojë Leje mjedisore të tipit B (me kod III.1.B) ose Leje Mjedisore të tipit A (me kod III.1.C) së bashku me akt Miratimin përkatës si dhe liçencën profesionale përkatëse të kategorisë III.2.B (*Për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme Spitalore*) që të përfshijnë mbetje të rrezikshme me kod 18 01 01; 18 01 03; 18 01 04, ku procedura e asgjësimit të jetë Autoklavim.

2.2. Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:

- a) Kopje të certifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit (**2017, 2018, 2019**) të operatorit ekonomik pjesmarrës, të paraqitura në autoritetet përkatëse dhe të konfirmuara nga ky autoritet.
- b) Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit (**2017, 2018 dhe 2019**) ku vlera mesatare e tyre të jete sa vlera e **fondit limit** të kontratës që prokurohet.
- c) Një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik

2.3 Për kapacitetin teknik :

a) Dëshmi nga operatori ekonomik për shërbime të ngjashme në një vlerë sa 40% e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit.

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme me një ent publik, kërkohet kontrata/kontratat përkatëse të shoqeruara me vërtetimin e realizimit me sukses të saj/te tyre.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm faturat tatimore të shitjes, ku të shënohen qartë datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për periudhën (Janar 2020 e në vijim), Per kete OE duhet te paraqese:

-Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme, dhe

-Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme.

Numri mesatar i punonjësve gjatë periudhes Janar 2020 të jetë jo më i vogël se **4** (katër) punonjës ndër të cilët njëri nga punonjesit duhet të jetë inxhinjer mjedisi, me qëllim realizimin me sukses të këtij Shërbimi.; në lidhje me këtë ofertuesi duhet të paraqesë vërtetim nga dega e tatim taksave për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të shoqëruara dhe me listëpagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore, ndersa për inxhinjerin e mjedisit duhet të paraqitet:

- Kopja e diplomes së Universitetit;
- Vërtetim nga Tatimet ku të figurojë tek listëpagesat sipas formularit E-SIG 025 ose Kontratë Pune e lidhur me inxhinjerin e mjedisit.

Librezë pune Përkatëse

CV përkatëse

Kontratë pune e vlefshme Përkatëse

c) Për transportin e mbetjeve, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë 2 (dy) automjete të izoluar hermetikisht,lehtësisht të identifikueshëm gjatë transportit të mbetjeve me shenjën dalluese ndërkombëtare të rrezikut të mbetjes mjekësore në përputhje me pikat 8.8/c dhe shtojcën nr. 4 të VKM-së Nr. 798 datë 29.09.2010 dhe sipas përcaktimeve të bëra në Udhëzuesin kombëtar “Administrimi i sigurtë i mbetjeve Spitalore” seksioni 9.3.3 (automjetet /anijet e grumbullimit).Operatori duhet të paraqesë dokumentacionin për vërtetimin e pronësisë osë të marrjes me qera të mjetit .

- Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë:
 - Për automjetin në pronësi:*Aktin e pronësisë së mjetit, leje qarkullimi, akt - kolaudimi dhe polica e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorrike për automjetet së bashku me Akt - Miratimet Higjenosanitare, si dhe foto të mjeteve ku të duket qarte targa dhe sinjalistika perkatëse.*

Për automjetet që nuk janë në pronësi: Kontratë qiraje të shoqëruar me aktin e pronësisë së qiradhënësit, ku afati i marrjes me qira të automjetit të jetë minimalisht me afatin e ekzekutimit objekt prokurimi, si dhe leje qarkullimi, akt-kolaudim dhe polica e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorrike për automjetet së bashku me Akt - Miratimet Higjenosanitare.

d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një kontratë të lidhur me një landfill të licensuar për depozitim të produktit final që del nga asgjësimi/trajtimi, e cila duhet të jetë aktive në momentin e hapjes së ofertave dhe e vlefshme për minimalisht 12 muaj pas hapjes së ofertave (sa kohezjatja e marrvëshjes kuader).

e) Operatori duhet të ketë në pronësi ose me qera impiant për asgjësimin e secilës kategori të prokuruar nga A.K të mbetjeve spitalore sipas Ligjit Nr. 10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, si dhe të VKM-se Nr. 798 datë 29.09.2010 për miratimin e rregullores “Për administrimin e mbetjeve spitalore”, (Rregullorja).

Për këtë Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Dokumentacionin për vertetimin e pronësise ose të marrjes me qera të pajisjes (ku afati i marrjes me qera të jetë minimalisht me afatin e ekzekutimit të këtij objekti prokurimi);
- Lejen mjedisore të impiantit të leshuar nga Min. Mjedisit, ku parashikohet trajtimi i mbetjeve objekt prokurimi;
- Si dhe duhet të paraqesi të markuar: katalog të impiantit perkates, ku përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme, për secilën procedurë asgjësimi të kërkuar nga A.K.

Shënim: KVO rezervon të drejtën e verifikimit të të dhënave të paraqitura nga ofertuesit.

(të plotësohet nga autoriteti kontraktor)

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Specifikimi i Materialeve, Skicimet, parametrat teknik etj:

Mbetjet e rrezikshme spitalore dhe anatomike duhet të asgjësohen në një impiant për incenerim i cili është i licencuar nga Ministria e Mjedisit për kryerjen e këtij shërbimi sipas përcaktimeve të më poshtme në lidhje me to :

1. Trajtimi i mbetjeve spitalore ne DSHSKukes te behet ne përputhje me Ligjin nr. 156 datë 10/10/2013”per disa ndryshime ne ligjin nr.10463, datë 22.9.2011 “per menaxhimin e integruar te mbetjeve”; ligjin nr. 9537, date 18/05/2006 “Per administrimin e mbetjeve te rrezikshme”; VKM nr. 99, date 18/02/2005”per miratimin e katalogut shqiptar te klasifikimit te mbetjeve; VKM nr.798 dt. 29/09.2010 “Per miratimin e rregullores”Per administrimin e mbetjeve spitalore”; VKM nr.371 datë 11.06.2014 "Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre" .
2. Ndarja e mbetjeve te rrezikshme nga te parrezikshmet te behet ne përputhje me Udhëzuesin Kombëtar për Administrimi i Sigurt e Mbetjeve Spitalore te ministrisë se Shëndetësisë .
3. Te gjitha mbetjet spitalore si **“instrumente të mprehtë”** që mund të shkaktojnë shpime apo prerje, **“mbetje infektuese”** si mbeturinat e ndotura nga çdo lloj patogjeni si bakteriet, viruset, parazitët ose kërpudhat, te ambalazhohen ne kosha me ngjyrat dhe përcaktimet përkatëse, etiketohen dhe te asgjësohen sipas përcaktimeve ne udhëzuesin kombëtar për administrimin e sigurte te mbetjeve spitalore me kodet përkatëse Nr. 18.01.01, 18.01.02 18.01.03, 18.01.04, sipas seksionit 18 te VKM Nr.99 date 18.02.2005 “Për miratimin e katalogut Shqiptar te Klasifikimit te Mbetjeve.
4. Objekti i kësaj kontrate janë te gjitha mbetjet infektive te rrezikshme spitalore klasifikuar sipas kodit evropian si janë mbetjet e buta (pelena, pambuk, garza mjekimi, tamponë, fashë te ndryshme, sete infuzioni, sonda te ndryshme etj). Këtu futen edhe materialet e rrezikshme te mprehta, age, shiringa, bisturi, aparate serumi si dhe te gjitha mbetjet te klasifikuar si te rrezikshme nga autoriteti kontraktor.
5. Mbetjet e rrezikshme spitalore duhet te asgjësohen ne një impiant i cili është i licencuar nga ministria e Mjedisit për kryerjen e këtij shërbimi.
6. Operatori ekonomik, duhet te instaloje dy frigorifere me kapacitet jo me pak se 100 kg secili ne ambientet e Spitalit Kukes per ruajtjen e mbejtjeve te rrezikshme spitalore anatomike te lengshme dhe te ngurta deri ne momentin e transportimit per ne impiantin e asgjësimit ne ambientet e SUT për te pershtatshem per ruajtjen e mbetjeve te rrezikshme te buta dhe te ngurta, deri ne momentin e transportimit për ne impiantin e asgjësimit. Mjeti për transportimin e mbetjeve te rrezikshme spitalore duhet te jete e mbyllur dhe te stampuara me shenjrat dhe mbishkrimet qe tregojnë “transport i mbetjeve te rrezikshme spitalore” sipas OBSH dhe te jene te pajisura me leje Higjeno-Sanitare.

7. Te sigurohet dezinfektimi i mire i frigoriferit dhe ambientit brenda dhe përreth vendit ku ruhen mbetjet pas cdo terheqje sasise mbetjesh.
8. Operatori ekonomik te furnizojë Drejtorinë e Shërbimit Spitalor Kukes me të gjitha materialet nevojshme për ambalazhimin e tyre si qese plastike, kuti për mbetjet e buta dhe kontenier për mbetjet e mprehta etj. Këto materiale duhet të jenë në ngjyrë të verdhë dhe të kenë të stampuar logon ndërkombëtare për mbetjet e rrezikshme spitalore.

Mbetjet duhet të merren nga sipërmarrësi pranë Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Kukes me mjet të posaçme të sipërmarrësit dhe ambalazhin përkatës në përputhje me standardet e OBSH-së për mbetjet e rrezikshme spitalore specifitimeve teknike për mbetjet e rrezikshme spitalore të ngurta dhe të lëngshme.

Trajtimi duhet të realizohet sipas legjislacionit në fuqi dhe mbetjet duhet të bëhen jo të rrezikshme.

Tërheqja e mbetjeve spitalore të bëhet çdo ditë, çdo dy ditë e çdo javë, në varësi të fluksit të mbetjeve por dhe sigurimit të kushteve frigoriferike. Operatori ekonomik kontraktues, të caktojë një person kontakti që do të mbajë lidhje me Drejtorinë e Shërbimit Spitalor Kukes për çdo problem dhe emergjencë.

9. Mbetjet e vendosura në ambalazh do të peshohen në praninë e përfaqësuesve të të dy palëve, hartohet proces - verbali për sasinë e peshuar në tre kopje dhe nënshkruhet nga sipërmarrësi dhe përfaqësuesi i autoritetit kontraktor. Dy kopje mbeten në Drejtorinë e Shërbimit Spitalor dhe një kopje e merr kontraktuesi. Tek formulari i transferimit të mbetjeve të rrezikshme spitalore të shenohen dhe kodet perkatese për cdo lloj mbetje.

10. Qeskat dhe kontenierët duhet të furnizohen nga operatori ekonomik. Qeskat duhet të jenë me një përdorim. Kontenierët duhet të jenë plastik, dhe të ofrohen minimalisht 2 permasa për kontenieret e vegjel për mbetjet e mprehta, me kapacitet nga 3 L në 7 L (për të mprehtat), dhe minimalisht 4 permasa për kontenieret e medhenj për mbetjet infektive dhe ato të përgjithshme nga 30 L deri në 70 L (nga keto, të pakten njëra nga permasat duhet të jetë me pedale dhe me rrota që të ketë opsionin e levizshmerisë me karrele). Të gjithë kontenierët që përdoren nga spitali duhet të merren nga OE dhe të bëhet dezinfektimi i tyre prej saj. Ngjyrat dhe markimet e kontenitoreve duhet të jetë sipas përcaktimeve të bëra në VKM-në Nr.798, dt.29.09.2010 “Për administrimin e mbetjeve spitalore”, si dhe Udhëzuesit kombëtar “Administrimi i Sigurtë i mbetjeve Spitalore.

Në bazë të pikës 6 të nenit 26 të VKM nr.371 datë 11/06/2014, operatori ekonomik dhe autoriteti kontraktor duhet të hartojnë në bashkëpunim, çdo tre muaj, dokumentin e transferimit të mbetjeve, një kopje e të cilit i dërgohet Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.

- Afati i realizimit të shërbimit do të jete 12 muaj nga nga data e nënshkrimit të marrëveshjes kuader.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në marrëveshjen kuadër]

PLANIFIKIMI I KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR

☐ Shërbim: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër _____		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01	_____	_____
02	_____	_____
03	_____	_____
...	_____	_____

Shtojca 10

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet :

“Trajtim dhe evadim i mbetjeve spitalore, në Drejtorinë e Shërbimit Spitalor Kukes”

- Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara

- me afat 1 vjeçar (12 muaj) ”.

(Një operator të vetëm ekonomik fitues).

	Pershkrimi I Shërbimeve	Sasia/kg
1	Te mprehta (age, ampula , drena bisturi, shishe qelqi, vigona	4851
2	Plastike (shiringa ,aparate perfuzioni , shishe serumesh , tuba , kateter	4180
3	Mbetje anatomike	1089
4	Te tjera (garza , pambuk , leukoplast)	880
	Totali ne kg	11000

Afatet e ekzekutimit:

Nga data e lidhjes së Kontratës, deri në 12 muaj nga data e nënshkrimit të marrëveshjes kuadër, sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.

Shtojca 11*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)***TERMAT E REFERENCËS**

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: Trajtim dhe evadim i mbetjeve spitalore i mbetjeve të Rrezikshme Spitalore DSHSK.

Detyrat: Operatori Ekonomik duhet të paraqitet sa herë merr njoftime nga Autoriteti Kontraktor, në bazë të nevojave të këtij të fundit.

Shpërndarja:

Shpërndarja do të realizohet në varësi të mbetjeve të prodhuara dhe të grumbulluara pranë Autoritetit Tonë Kontraktor, sipas muajve përgjatë 12 muajve dhe të ndara në tabelën më poshtë:

Nr.	Pershkrimi	Sasia/kg
1	Te mprehta (age, ampula , drena bisturi, shishe qelqi, vigona	4851
2	Plastike (shiringa ,aparate perfuzioni , shishe serumesh , tuba , kateter	4180
3	Mbetje anatomike	1089
4	Te tjera (garza , pambuk , leukoplast)	880
	Totali	11000

Vendi i kryerjes së shërbimeve: **Drejtoria e Sherbimit Spitalor Kukes**

Shtojca 12

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR³

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” .

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s’kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme :

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt
< Emri >

³ Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore.

Shtojca 13

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët ☐ oferta ekonomikisht më e favorshme ☐

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

2. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë *[emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]* se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej *[shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*/pikët totale të marra *[_____]* është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit]* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 14

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: ☐ oferta ekonomikisht më e favorshme ☐ çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>
2. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 15.

**KUSHTET E PËRGJITHSHME
Shërbimet –Kërkesë për propozim**

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e shërbimeve të prokuruar me anë të procedurës kërkesë për propozim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjane kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë, gjithashtu, Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Shërbimet që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.4 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.

- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen shërbimin. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate shet Shërbimet.
- 2.7 “Shërbime” do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Kontraktuesi sipas kontratës.
- 2.8 “Termat e References” shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4 Praktikë Korruptive, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktues mund t’i kërkojë Gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose njësi që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktues të inspektojë llogaritë dhe procesverbalet që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 5 Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t’i japë nenkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktues deri në masën e kërkuar për nenkontraktuesin në mënyrë që ai të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nenkontraktuesin një dispozitë që premtonte ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6 Prona Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë Kontrates do t'i përkasin Autoritetit Kontraktues i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Furnizuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoriteti Kontraktues të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikën, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose pregatitura nga Kontraktuesi gjatë kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktues.
- 6.3 Kontraktuesi duhet të sigurojë Autoritetin Kontraktues nga mospërgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose kryerja e Shërbimeve sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoriteti Kontraktues në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i gjërave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoriteti Kontraktues të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7 Detyrimet e Përgjithshme të Kontraktuesit

- 7.1 Kontraktuesi duhet t'i kryejë Shërbimet dhe përmbushi detyrimet e tij me të gjitha përpjekjet, eficiente dhe ekonomike në pajtim me teknikat dhe praktikat profesionale të pranueshme në përgjithësi.
- 7.2 Kontraktuesi duhet të ndjekë praktika të shëndosha të biznesit dhe të përdorë teknologji të avancuar dhe të përshtatshme si dhe metoda të sigura.
- 7.3 Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të veprojë gjithmonë si një këshillues besnik i Autoriteti Kontraktues, në pajtim me rregullat dhe kodin e sjelljes të profesionit të tij dhe duhet që të mbështeti dhe ruajë gjithmonë interesin publik.
- 7.4 Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të ushtrojë kujdes të plotë në mardhëniet me palët e treta duke përfshirë median dhe nuk duhet të marrë pjesë në veprime që janë jashtë kompetencës së tij në përfaqsimin e Autoritetit Kontraktues.

